



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE

Nr. 1349 Rep

Nr. 219 Kol

Elbasan me 17.01.2000

KONTRATE SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot me date 17.01.2000 perpara meje noteres Anila Batalli u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

SHITES :Arben Doko , i biri i Samiut , i dtl 26-09-1963 , lindur dhe banues ne Elbasan , lagja ‘ Dyli Haxhire ‘ i identifikuar nepermjet pashaportes nderkombetare me nr : 0348884 .

BLERES:Fatbardh Doko , i biri i Samiut , i dtl 30-06-1959 , lindur ne Fier dhe banues ne Elbasan , lagja ‘ Dyli Haxhire Myzyri ‘ i njohur personalisht prej meje .
te cilet pasi u identifikuan prej meje ne baze te ligjit dhe me rezultuan ne moshe madhore dhe te afte per te kryer veprime juridike me kerkuar redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash te shoqerise "**SH.SH.M.N. DOKO** “si me poshte vijon :

Shitesi i mesiperm verteton nepermjet vendimit te Gjykates se rrethit Tirane me Nr 13564 date 30-01-1994 se zoteron 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "**SH.SH.M.N. DOKO** “ sh.p.k .-----

Shitesi Arben Doko deklaroi ne pergjegjesine e tij ligjore dhe me vullnet te lire se i shet z. Fatbardh Doko 50 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "**SH.SH.M.N. DOKO** “ sh.p.k. te cilat i zoteron ne baze te aktit te themelit dhe vendimit te gjykates per rregjistrimin e shoqerise "**SH.SH.M.N. DOKO** “sh.p.k.

Ne kete menyre shoqeria "**SH.SH.M.N. DOKO** “ sh.p.k. do te kete ortake te saj Z. Arben Doko me 50 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise dhe Z. Fatbardh Doko me 50 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise "**SH.SH.M.N. DOKO** “.

Palet deklarojne se jane ne mirebesim ne kete kontrate shitblerje kuotash duke qene te qarte se mbi kete kapital nuk rendon asnje barre apo pengese ligjore per kalimin e pronesise se tyre nga shitesit tek blesesi .-----

Kontrata e shit-blerjes se kuotave te shoqerise "**SH.SH.M.N. DOKO** “ sh.p.k u redaktua ne 4 kopje te njejta dhe pasi u gjet ne rregull dhe konform vullnetit te paleve kontraktuese u firmos rregullisht prej tyre ne pranine time si notere.

SHITES

Arben Doko
[Signature]

BLERES

Fatbardh Doko
[Signature]

NOTERE

Anila Batalli

